



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 28

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 5 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 7, datë 19.2.2018	Për miratimin e elementeve dhe formës së kontratës së shërbimit ndërmjet institucionit të arsimit të lartë jopublik dhe studentit..... 2055
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 9, datë 23.2.2018	Për disa shtesa në udhëzimin e MASH-it nr. 21, datë 23.7.2010, “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar..... 2056
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 11, datë 23.2.2018	Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2018.... 2057
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 117, datë 16.2.2018	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe detyrave të zëvendësministrit në Ministrinë e Kulturës..... 2057
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 23.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 113, datë 8.7.2016..... 2058
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 23.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 2059
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 23.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, “Seta 3” dhe “Seta 4”..... 2059
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 23.2.2018	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e rregullave operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror..... 2060

Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 10, datë 16.2.2018	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për shoqërinë Ujësjetllës Malësi e Madhe sh.a.....	2061
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 11, datë 16.2.2018	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Maliq sh.a.....	2062
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 12, datë 16.2.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 28.4.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Tepelenë”	2063

**UDHËZIM****Nr. 7, datë 19.2.2018****PËR MIRATIMIN E ELEMENTEVE
DHE FORMËS SË KONTRATËS SË
SHËRBIMIT NDËRMJET
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË
LARTË JOPUBLIK DHE STUDENTIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Kontrata e shërbimit që lidhet ndërmjet IAL-së jopublike dhe studentit duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

a) Të dhënat e plota për IAL-në jopublike dhe emrin e administratorit të saj në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të IAL-së;

b) Të dhënat e plota për identitetin e studentit;

c) Objektin e kontratës;

d) Bazën ligjore;

e) Afatin e kontratës;

f) Emërtimin e programit të studimit;

g) Vitet akademike, kreditet dhe planin mësimor;

h) Tarifën e studimit dhe mënyrën e pagesës së tarifës së studimit, duke përfshirë një grafik të të gjitha pagesave, të rimbursueshme dhe të parimbursueshme;

i) Afatet e pagesës së tarifës së studimit;

j) Rastet e pjesëmarrjeve në sesionet e provimeve shtesë dhe tarifatat për këto pjesëmarrje;

k) Përgjegjësinë për vonesën apo mospagesën e tarifës së studimit;

l) Të drejtën e studentit për të hequr dorë nga kontrata në fillim të vitit të parë akademik;

m) Të drejtat e palëve në kontratë, për prishje të njëanshme të kontratës pas fillimit të vitit të parë akademik;

n) Rastet e pamundësisë për të përfituar nga programi i studimit, nga studentit;

o) Sigurimin e studentit në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera;

p) Të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratë;

q) Të drejtat dhe detyrimet lidhur me publikimin e imazheve të studentëve;

r) Detyrimin e IAL-së për mbrojtjen e të dhënave personale;

s) Deklarimin nga ana e studentit përpara nënshkrimit të kontratës, se ajo është lexuar, kuptuar dhe rënë dakord, lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve në kontratë, si dhe me rregullat e ndërprerjes së kontratës dhe të rimbursimit;

t) Deklarimin nga ana e studentit për marrjen përsipër të ruajtjes së konfidencialitetit të kontratës.

u) Deklarimin nga ana e studentit se nuk është regjistruar dhe nuk është duke ndjekur asnjë program tjetër studimi në institucion tjetër të arsimit të lartë, njëkohësisht.

2. Kontrata e shërbimit që lidhet ndërmjet IAL-së jopublike dhe studentit, hartohet dhe nënshkruhet në formën e kërkuar nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

3. Në përmbajtje të kontratës së shërbimit duhet të paraqiten qartë:

a) E drejta e studentit për të hequr dorë nga kontrata dhe t'i rimbursohen plotësisht pagesat e bëra për ndjekjen e orës së parë të mësimit ose 7 ditë pas nënshkrimit të kontratës së regjistrimit, cilado qoftë më e vonshme prej këtyre datave;

b) Ndarjen e pagesës së tarifës së studimit në këste, në mënyrë të tillë që studenti të paguajë paraprakisht deri në 50% të pagesës për semestër;

c) Përcaktimin e të gjitha tarifave në mënyrë të qartë në kontratë që në momentin e regjistrimit, përfshirë pjesëmarrjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme në sezonet e provimeve, ceremonitë dhe kostot e diplomimit etj.;

d) Detyrimin kontraktor të IAL-së, për të mos shtuar tarifa të tjera, përveç atyre të parashikuara në kontratën e shërbimit deri në pajisjen me diplomë të studentit;

e) Të drejtën e studentit për t'u siguruar nga institucioni i arsimit të lartë jo publik, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera;

f) Të drejtat e rimbursimit të studentit në rastet e transferimit apo ndërprerjes së studimeve, duke përcaktuar qartazi në kontratë



se tarifa e studimit që do të paguhet nga studenti do të jetë vetëm për semestrin e fundit që ka ndjekur ose është duke ndjekur studenti;

g) Rregullat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe gjykatën kompetente për rastet e mosmarrëveshjeve të pazgjidhura ndërmjet palëve.

4. Kontrata e shërbimit të shoqërohet me dokumentin e performancës së institucionit të arsimit të lartë, e cila ndër të tjera duhet të përmbajë dhe:

a) të dhëna mbi politikën dhe performancën e institucionit;

b) përqindjen kaluese për programin e studimit që do të ndjekë studenti;

c) përqindjen e kaluesve në provimin e shtetit në rast se aplikohet ky provim;

d) përqindjen e punësimit të studentëve në programin përkatës të studimit për tri vitet e fundit.

5. Kontrata të firmoset dhe t'i vendoset data e nënshkrimit nga vetë studenti ose personi i autorizuar prej tij me prokurë të posaçme.

6. Studenti apo çdo person publik ka të drejtë të marrë informacion dhe/ose të paraqesë ankim për të kontaktuar strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në numrin e telefonit të publikuar në faqen elektronike zyrtare ose duke plotësuar letrën e ankesës që mund të shkarkohet nga kjo faqe, për rastet e mosrespektimit të këtij udhëzimi.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në MASR, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Institucionet e Arsimit të Lartë dhe studentët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 9, datë 23.2.2018

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN E MASH-IT NR. 21, DATË 23.7.2010, “PËR NORMAT E PUNËS MËSIMORE- EDUKATIVE DHE NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26, pika d, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e MASH-it nr. 21, datë 23.7.2010, “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën “IV”, “Norma të veçanta”, pas shkronjës “b”, të pikës 2, shtohet shkronja “c”, me përmbajtjen si më poshtë:

“c. Për zhvillimin e veprimtarive të miratuara në kuadër të programit të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, ora e studimit të trajtohet e barasvlershme si orë mësimore, për efekte financiare. Në çdo institucion arsimor të përfshirë në nismë të realizohen jo më shumë se 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të krijuar”.

2. Në pikën “V”, “Numri i nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me përmbajtje si më poshtë:

“3.1 Numri i nxënësve për klasë në kuadër të programit të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, të jetë 25 nxënës për një klasë studimi. Në rastet kur numri i nxënësve për një klasë studimi nuk plotësohet me 25 nxënës, shkolla mund të krijojë një klasë studimi me jo më pak se 15 nxënës.”

3. Këto shtesa zbatohen në të gjitha shkollat e përfshira në programin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” sipas urdhrit nr. 11, datë 10.1.2018, “Për pilotimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, në institucionet shkollore të arsimit bazë”.

4. Efektet financiare për zbatimin e këtij udhëzimi përballohen me fondet e buxhetit të



shtetit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 8.3.2017, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Mirëmenaxhimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 11, datë 23.2.2018

PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR 2018

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 25 maj 2018, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.

2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor fillon në orën 10.00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.

4. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2018”.

5. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe standardin e tyre.

6. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.

7. Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.

8. Arkivimi i testeve bëhet pranë njësite arsimore vendore (DAR/ZA-ve).

9. Sektori i Statistikës i DAR/ZA-ve merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit (QVT) dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, ISHA dhe MASR.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

URDHËR

Nr. 117, datë 16.2.2018

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E KULTURËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 22 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 3, 5 dhe 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e fushave të përgjegjësisë dhe detyrave të zëvendësministrit në Ministrinë e Kulturës, znj. Valbona Shujaku, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.



2. Zëvendësministri i Kulturës, znj. Valbona Shujaku, të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore sipas këtyre prioriteteve:

a) Hartimin e programit kombëtar të “Edukimit përmes kulturës”, për vitin arsimor 2018–2019;

b) Koordinimin e kalendarit të aktiviteteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore që zhvillohen në kuadër të edukimit përmes kulturës;

c) Bashkëpunimin me institucionet e përfshira në programin kombëtar të edukimit përmes kulturës;

ç) Drejtimin e grupit të punës për hartimin e “Strategjisë kombëtare të kulturës”, brenda vitit 2018;

d) Koordinimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për angazhimin e tyre në hartimin e “Strategjisë kombëtare të kulturës”;

dh) Zhvillimin e takimeve dhe angazhimin e organizatave kulturore aktive në fushën e artit dhe kulturës, pjesë e rrjetit “Skena e pavarur kulturore”, në hartimin e “Strategjisë kombëtare të kulturës”;

e) Koordinimin dhe ndjekjen që nga faza e hartimit deri në zbatimin e “Kalendarit të përbashkët kulturor Shqipëri–Kosovë 2018”.

3. Përveç ndjekjes dhe raportimit të çështjeve të mësipërme, zëvendësministri ngarkohet të ndjekë edhe çështje të tjera, në zbatim të urdhrave të ministrit.

4. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Valbona Shujaku, për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri i ministrit të Kulturës nr. 43, datë 19.1.2018, “Për caktimin e fushës së veprimtarisë që mbulon zëvendësministri në Ministrinë e Kulturës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro (Furxhi)

VENDIM

Nr. 38, datë 23.2.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 113, DATË 8.7.2016.

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.2.2018, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 113, datë 8.7.2016, ka vendosur të miratojë “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.

- Në datën 6.2.2018, në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë OSHEE sh.a. me nr. 2312 prot. (protokolluar në ERE, me nr. 171, datë 12.2.2018), nëpërmjet së cilës OSHEE sh.a. kërkon nga ERE amendimin e dispozitave të kësaj rregulloreje, që kanë të bëjnë me lejin e abonentëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a., për disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 113, datë 8.7.2016, si më poshtë:

a) Lejimin e klientëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se debia merret përsipër nga furnizuesi i ri;

b) Lejimin e klientëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se midis furnizuesit të mëparshëm dhe klientit ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë dhe palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 39, datë 23.2.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “WIND POWER ALBANIA” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 164 prot., datë 7.2.2018, ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 40, datë 23.2.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HYDRO SETA” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “SETA 1+2”, “SETA 3” DHE “SETA 4”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi



fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, me fuqi të instaluar 7454 kw; “Seta 3”, me fuqi të instaluar 2722 kw dhe “Seta 4”, me fuqi të instaluar 4724 kw dhe me fuqi totale të instaluar 14900 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 165 prot., datë 8.2.2018, shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, “Seta 3” dhe “Seta 4”.

- Nga analiza e bërë dokumentacionit të paraqitur në këtë aplikim, rezulton se shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4, 4.4.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 4.1.4, germa “a” dhe germa “d” do të njoftohet subjekti që ta plotësojë atë brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, me fuqi të instaluar 7454 kw; “Seta 3”, me fuqi të instaluar 2722 kw dhe “Seta 4”, me fuqi të instaluar 4724 kw

Faqe | 2060

dhe me fuqi totale të instaluar 14900 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 41, datë 23.2.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE OPERACIONALE PËR FURNIZUESIN E MUNDËSISË SË FUNDIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 90, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 19, pika 1, germa “f” dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 90, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE miraton “Rregullat operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 10, datë 16.2.2018

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS MALËSI E MADHE SHA

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të

vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Malësi e Madhe sh.a., si më poshtë:

Kategoria	Tarifat volumetrike	Tarifa shërbimi fikse	Tarifa flet (aforfe)
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë (me matës)	lekë/m ³	lekë/muaj	lekë/muaj
1. Konsumator familjar	50	167	
2. Konsumator publik	120	167	
3. Konsumator privat	120	167	
b) Për shërbimin e furnizimit me ujë (pa matës)			
1. Konsumator familjar		167	666
c) Për shërbimin e furnizimit nga çezmat publike			500

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 të jenë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018
Uji pa të ardhura	62.7%
Niveli i matjes	44%
Norma e arkëtimit	65%
Mbulim i kostove totale	83%
Orët e furnizimit me ujë	16 orë
Staf për 1000 lidhje	13.2 punonjës

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës Malësi e Madhe sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani



VENDIM
Nr. 11, datë 16.2.2018

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA, PËR
SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME
MALIQ SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të

vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Maliq sh.a., si më poshtë:

Njësitë administrative	Kategoria	Tarifat volumetrike	Tarifa fikse shërbimi	Tarifë aforfe	
				Për ujin e pijshëm	Për kanalizime
Maliq, Libonik, Pojan, Vreshtas, Përg (zona fushore)	a) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime	lekë/m³	lekë/muaj	lekë/muaj	lekë/muaj
	1. Konsumator familjar	45	54		50
	2. Konsumator publik	100	54		50
	3. Konsumator privat	105	54		50
	b) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime (pa matës)				
Maliq Libonik, Përg, Gore, Moglicë (zona malore)	1. Konsumator familjar		54	450	50
	a) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime	lekë/m³	lekë/muaj	lekë/muaj	lekë/muaj
	1. Konsumator familjar	22.5	27		0
	2. Konsumator publik	100	54		0
	3. Konsumator privat	105	54		0
	b) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime (pa matës)				
	1. Konsumator familjar		27	225	0

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 të jenë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Norma
Uji pa të ardhura	31%
Niveli i matjes	57%
Norma e arkëtimit	85%
Mbulimi me ujë	74%
Mbulimi me kanalizime	43%
Orët mesatare të furnizimit me ujë	13 orë
Staf për 1000 lidhje	8.6 punonjës



3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Maliq sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 12, datë 16.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 15, DATË 28.4.2017, “PËR
LICENCIMIN E SHA UJËSJIELLËS-
KANALIZIME TEPELENË”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 15, datë 28.4.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tepelenë”, bëhen këto ndryshime:

1. Drejtues teknik: Vladimir Lala
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë